



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

KRYETARI

Nr. 2315 prot.

Vau Dejes, më 18.04.2022

Lënda: Kërkese për mbledhje jashtë radhës

KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

Duke marrë shkas nga nevoja për krijimin e Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, për menaxhimin e tregjeve bujqësore , grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore të agrikulturës dhe agropërpunimit, dhe si pasojë e mundësisë për aplikimin për fonde mbështetëse deri me datën 29.04.2022, mbështetur në Udhëzimin nr 01 dt 11.02.2022 ‘Kriteret , procedurat dhe mënyra e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural» kërkojë që të mbledhet Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, jashtë radhës , mbështetur në Nenin 53, pika 3, germa a e Ligjit nr 139/2015 ” Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar. Këshilli të mbledhet për miratimin e Projekt Vendimit Nr 01 Prot datë 19.04.2022 ” Për krijimin e shoqërisë ‘Zadrime Agrikulturë ”, shpk si person juridik në pronësi të Bashkisë Vau Dejës dhe miratimin e akteve të themelimit.

KRYETARI

MARK BABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE DHE KONTRATAVE

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@vaudejes.gov.al

Nr. 2314 prot.

Vau Dejës, më 19, 04, 2021

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Z. Mark Bisha

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, për:

“Për krijimin e shoqërisë “ Zadrime Agrikulture ” shpk, si person juridik në pronësi të Bashkisë Vau Dejës dhe miratimin e akteve të themelimit”

Me respekt

KRYETAR

MARK BABANI



Miratoi:

Kristinë Shtatri: Përgjegjës i Sektorit të Asistencës Ligjore, Çështjeve Gjyqësore dhe Kontratave

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: _____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: _____

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE DHE KONTRATAVE

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@vaudejes.gov.al

PROJEKT VENDIM

Nr. 01 datë 13.04 2022

**“PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “ ZADRIMA AGRIKULTURE ” SHPK, SI
PERSON JURIDIK NË PRONËSI TË BASHKISË VAU DEJËS DHE MIRATIMIN E
AKTEVE TË THEMELIMIT”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1.1 shkronja “b”, pika 1.6, shkronja b, neni 54, shkronja d e Ligjit Nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji nr 9901, dt 14.04.2008” Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, propozimin e Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, i propozojmë Këshillit të Bashkisë, të:

VENDOSI

1. Krijimin e shoqërise me emërtimin tregtar “ Zadrime Agrikulture”sh.p.k shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e zotëruar në masën 100 (njëqind) % të kapitalit të shoqërise nga Bashkia Vau Dejës, me objekt veprimtarie : Menaxhimi i tregjeve të produkteve bujqësore, grumbullimi dhe ruajtja e produkteve bujqësore të agrikulturës, agropërpunimit etj.
2. Miratimin e aktit të themelimit dhe statusit të shoqërisë “Zadrime Agrikulture” shpk . Të ngarkojë kryetarin e Bashkisë apo personin e autorizuar prej tij, që të nënshkruaje aktet e themelimit të kësaj shoqërie tregtare.
3. Shoqëria “ Zadrime Agrikulture” shpk, themelohet, organizohet dhe funksionin si shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me parashikimet e ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.
4. Kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë “ Zadrime Agrikulture” shpk, të jetë 100 (njëqind)lekë.
5. Shoqëria“ Zadrime Agrikulture” shpk, fillimisht të ketë seline qendrore në adresën , Rruga Qafa e Gurit, pranë Zyrrave të Bashkisë Vau Dejës.

6. Shoqëria “ Zadrimea Agrikulture” shpk, të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar.
7. Kryetari i Bashkisë, brenda 15(pesëmbëdhjetë) diteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi , në përputhje me parashikimet e ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar dhe ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, emëron administratorin e shoqërisë.
8. Efektet financiare për zbatim e këtij vendimi, për krijimin e kapitalit fillestar të shoqërisë, në vlerën 100(njëqind)lekë, përballohen nga buxheti i vitit 2022, dhe bashkia Vau Dejës transferon këtë shumë pranë kësaj shoqërie menjëherë pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombetare të Biznesit.
9. Bashkia Vau Dejës, brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndjek procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë “ Zadrimea Agrikulture” shpk, në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
10. Shoqëria “ Zadrimea Agrikulture” shpk, ka në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të shqyrtojë dhe të vlerësojë mundësinë e bashkëpunimit me shoqëri të tjera tregtare dhe të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me persona të tretë.
11. Të autorizojë kryetarin e Bashkisë ose personin e deleguar prej tij, që të përfaqësoje Bashkinë Vau Dejës, në cilësinë e ortakut të vetëm për kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për përgatitjen dhe nënshkrimin e akteve të themelimit të shoqërisë së re dhe regjistrimin e saj sipas legjislacionit në fuqi.
12. Bashkia Vau Dejës i siguron shoqërisë “ Zadrimea Agrikulture” shpk, nga inventari i saj i pronave të paluajtshme , mjediset e nevojshme për regjistrimin e saj sipas legjislacionit në fuqi.
13. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë , Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritetit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
14. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” .

KRYETAR
MARK BABANI

Pergatiti:

Kristine Shtatri

Pergjegjes i Sektorit të Asistencës Ligjore,

Çështjeve Gjyqësore dhe Kontratave



STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ZADRIMA AGRIKULTURE SHPK

Sot, me datë ____ . ____ .2022, Ortaku themelues :

BASHKIA VAU DEJËS, person juridik publik, organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me adresë të regjistruar “ Qafa e Gurit” Vau Dejës, përmes këtij akt themelimi.

DISPOZITATE PERGJITHSHME

Neni 1

Shoqëria është person juridik i së drejtës shqiptare dhe gëzontë drejtat e personitjuridik nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Bizneseve Shoqëria zhvillonaktivitetin sa në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e aktit tëthemelimit të këtij statute.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 2

Menaxhimi i tregjeve të produkteve bujqësore, grumbullimi dhe ruajtja e produkteve bujqësore të agrikulturës, agropërpunimit etj.

- Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë sic parashikohet në këtë statut dhe ne ligj.

SELIA E SHOQËRISË

Neni 3

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ka selinë e saj në ambientet pranë zyrave të Bashkisë Vau Dejës, Rruga Qafa e Gurit, Vau Dejës

KOHEZGJATJA

Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jëtë pa afat ,me mundësinë e zgjatjes apo të shkurtimit të afateve, të ndryshojë veprimtarinë, emërtimin, selinë, objektin e veprimtarisë sipas vendimit të ortakëve të shoqërisë.

DETYRIMET E ORTAKEVE

Neni 5

Ortaku i vetëm i shoqërisë duhet të kryejë depozitimimin e kapitalit themeltar për llogari të shoqërisë në një bankë të caktuar prej tij.

TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6

Ortakët mund të kalojnë pjesën nga kapitali themeltar i personave të tjerë në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 73 të Ligjit nr 9901 datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

PARAQITJA KONTABILE

Neni 7

Operacionet e shoqërisë kontabilizohen duke aplikuar parimet e kontabilitetit të parashikuara në legjislacionin shqiptar dhe paraqitjen me saktësi në bilancin vjetor të aktivitetit.

Në mbyllje të çdo viti ortakët ose personi i ngarkuar prej tij, bën inventarizimin dhe llogaritë vjetore në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe harton raport me shkrim. Ky raport pasqyron gjendjen e shoqërisë gjatë vitit financiar.

KAPITALI THEMELTAR

Neni 8

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si vijon:

Lloji i kontributit është në para ne vlerën 100(njëqind)lekë, 1 kuote, që përbën 100 % vlerën e kapitalit themeltar të shoqërisë, që i përket BashkisëVauDejës.

OPERACIONET FINANCIARE

Neni 9

Shoqërië është e autorizuar për të siguruar mjete financiare dhe kredit duke ju drejtuar bankave, institucioneve të kreditit ose atyre të financimeve totale apo të jashtme, institucioneve ndërkombëtare të financimit dhe të kreditit sido që te jetë percaktuar.

BLERJET E SHOQËRIVE

Neni 10

Në Republikën e Shqipërisë, shoqëria gëzon të drejtën e saj për të zotëruar mjete të saj si në çdo shoqëri tjetër ose organizatë tregtare, kombetare shqiptare në përputhje me Ligjin nr 9901, datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

FONDI REZERVE

Neni 11

Shoqëria mund të themelojë një fond reserve si dhe fonde të tjera të veçanta për zhvillimin e tij. Përbërja, shuma totale, fondet për krijimin e tyre përdorimi dhe rregullimi i tyre përcaktohet nga ortakët i vetëm në përputhje me legjislacionin shqiptar. Vlerat materiale të shoqërisë raportohen në balance të shprehur në lekë shqiptare, në përputhje me rregullat në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Bilanci dhe përlogaritjet ekonomike të shoqërisë hartohen mbi bazën e formës së bilancit dhe llogaritjeve ekonomike të përcaktuara për shoqëritë tregtare në Shqipëri. Bilanci vjetor mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti.

PLANET FINANCIARE

Neni 12

Aktiviteti i shoqërisë mbi bazën e programeve financiare që bëjnë pjesën e aktivitetit financiar të saj. Planet financiare parashikojnë koston dhe të ardhurat e shprehura në lekë shqiptare. Gjendja pasurore dhe llogaritjet ekonomike do të paraqiten në lekë shqiptare. Rezultatet financiare të aktivitetit dhe të punës së kryer nga shoqëria, paraqiten në bilancin vjetor. Kursi i kembimit të monedhës shqiptare në monedhat e huaja dhe e kundërta do të jenë ato të vendosura nga Banka e Shtetit Shqiptar.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13

Organi vendimarrës i shoqërisë “ Zadrime Agrikulture shpk është asambleja e ortakëve e përbërë nga 1 ortakë, Bashkia Vau Dejës.

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme: a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; b) ndryshimet e statutit; c) emërimin e shkarkimin e administratorëve; ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike; dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit; f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre; g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë; h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë; i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “ë” të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortakët i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortakët i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për: a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së

veprimtarisë; b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; c) investime; ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

MBLEDHJAE ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Neni 14

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji nr 9901 dt , nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.
3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.
8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve

MENYRAE THIRRJES

Neni 15

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE

Neni 16

1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

MARRJA E VENDIMEVE

Neni 17

1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

E DREJTA E VOTES

Neni 18

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

PROCESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESE

Neni 19

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
2. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
3. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
4. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
5. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

ADMINISTRATORI

Neni 20

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, sipas Ligjit nr 9901 date 14.04.2008. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të Ligjit nr 9901 dt 14.04.2008, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
3. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të: a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme; b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare; c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim; d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit; e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
4. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.
5. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.

6. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

SHFUQIZIMI I VENDIMEVE

Neni 21

Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit.

RASTET E PUNËS

Neni 22

1. Raportet e punës ndërmjet shoqërise dhe punonjësve të saj do të rregullohen në bazë të kontratës së punës sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë
2. Shoqëria merr përsiper, të shlyeje rregullisht të gjitha detyrimet e saj që burojnë nga legjislacioni për sigurimet shoqërore e shëndetësore lidhur me të punësuarit e saj.

PERFUNDIMI I AKTIVITETTT

Neni 23

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

1. Për pamundësinë e realizimit të objektit të saj
2. Me vendim të gjykatës
3. Me hapjen e procedurave të falimentit.

LIKUJDIMI

Neni 24

Likujdimi i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar do të bëhet sipas normave të legjislacionit shqiptar në fuqi në kohën e likujdimit.

KUSHTET E TJERA

Neni 25

1. Të gjitha vendimet e marra nga asambleja e ortakëve do të evidentohen në nje libër të vecante, i cili do të administrohet në selinë e shoqërise.
2. Për sa nuk është shprehur plotësisht dhe saktësisht në këtë statut, do ti referohen ligjeve në fuqi që rregullojnë këtë fushe dhe plotësimeve që do të bëjë ortaku i vetëm.


Ky statut firmoset rregullisht.

PËR SHOQËRINË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

ZADRIMA AGRIKULTURE SHPK

Ortaku i vetëm:

Mark Babani



RELACION

“PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “ZADRIMA AGRIKULTURË” SH.P.K., SI PERSON JURIDIK NË PRONËSI TË BASHKISË SË VAU DEJËS DHE MIRATIMIN E AKTEVE TË THEMELIMIT

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b” dhe pika 1.6, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “d” dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritit i parashtrajnë Këshillit Bashkiak relacionin si më poshtë vijon:

Bashkia Vau Dejës është organ publik që organizohet dhe funksionon në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar, rregullores së brendshme për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë së Vau Dejës, si dhe çdo akti ligjor dhe nënligjor në fuqi që rregullon ushtrimin e të drejtave dhe përbushjen e detyrimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në bazë të nenit 9, pika 1.6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, bashkitë si persona juridikë, gëzojnë dhe ushtrojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në legjislationin në fuqi, e ku njëra prej këtyre të drejtave konsiston në mundësinë e krijimit të personave të tjerë juridikë.

Gjithashtu, ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, parashikon që edhe njësitë e vetëqeverisjes vendore të kenë në pronësinë e tyre shoqëri që zhvillojnë veprimtari tregtare, me interes të përgjithshëm ekonomik, dhe ku themelimi, organizimi e funksionimi i të cilave iu nënshtrohen dispozitave të këtij ligji.

Bashkia Vau Dejës ka si synim kryesor përmisimin e cilësisë së jetës së banorëve të zonave rurale, nëpërmjet nërtimit të tregjeve bujqësoreve dhe dhomave frigoriferike për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore etj

Në këtë kuadër nga ana e Bashkisë është vendosur krijimi i një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “Zadrime Agrikulture” Sh.p.k e cila do të jetë një subjekt tregtar me Ortak të vetëm Bashkinë Vau Dejës dhe me një kapital fillestar 100 (njëqind) lek i ndarë në 1 (një), kuotë e zotëruar nga 100 % nga ortaku i vetëm. Kapitali fillestar mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Organizimi i strukturave të shoqërisë do të realizohet në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar. Referuar dispozitave të këtij ligji organet vendimarrëse të shoqërisë do të jenë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm/Ortakëve - organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori/ët - organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Detyrat dhe kompetencat e organeve janë përcaktuar në mënyrë të detajuar në Draftstatutin bashkëlidhur Projektvendimit. Kjo shoqëri do të administrohet nga Administratori i cili zgjidhet për një mandat pesëvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Nga pikëpamja e aktivitetit që do të ushtrojë shoqëria, ajo do të funksionojë si një strukturë e poscame dhe e specializuar në menaxhimin e tregjeve bujqësore, grumbullimin dhe ruajtjen e

produkteve bujqësore, të agrikulturës , agropërpunimit etj., dhe konkretisht shoqëria “Zadrima Agrikulturë” Sh.p.k do të ketë si objekt veprimtarie si më poshtë vijon:

- Menaxhimi i tregjeve bujqësore .
- grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore, të agrikulturës , agropërpunimit etj.
- Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë sic parashikohet në këtë statut dhe ne ligj.

Gjithashtu duke mbajtur në konsideratë faktin se sektori i bujqësisë është në një zhvillim të shpejtë, shoqëria tregtare do të sigurojë një përshtatje me dinamikat e zhvillimit të sektorit, si rezultat i mundësisë që ka për vendimmarrje të shpejta dhe lehtësinë nga pikëpamja ligjore për të hyrë në marrëdhënie tregtare me subjekte të tjera.

Për sa më lart, i propozojmë Këshillit Bashkiak krijimin e shoqërisë “Zadrima Agrikulturë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë së Vau Dejes dhe miratimin e akteve të themelimit”.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana juaj,

Përgjegjës i Sektorit të Asistencës Ligjore
Kristinë Shtatri

Kryetari
Mark Babani

**AKTI I THEMELIT TË SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ZADRIMA AGRIKULTURE SHPK**

Sot, me datë ____ . ____ .2022, Ortaku themelues :

BASHKIA VAU DEJËS, person juridik publik, organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me adresë të regjistruar “ Qafa e Gurit” Vau Dejës, përmes këtij akt themelimi.

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia e Shoqërisë

Neni 1

Themelimi, Themeluesit, Emri

Sot me datë ____ . ____ .2022 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Zadrime Agrikulture”shpk, në përputhje me ligjin nr 9901, datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar (këtu e më poshtë Shoqëria)

Shoqëria është një entitet ligjor shqiptar dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (shpk)

Themeluesit e shoqërisë “Zadrime Agrikulture”shpk, janë :

Bashkia Vau Dejës, me Nipt K56705007O, me kryetar Z. Mark Babani, me adresë “ Rruga Qafa e Gurit” Vau Dejës

Neni 2

Objekti i Shoqërisë.

Menaxhimi i tregjeve të produkteve bujqësore, grumbullimi dhe ruajtja e produkteve bujqësore të agrikulturës, agropërpunimit etj.

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë.

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 4

Selia e Shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Zadrime Agrikulture”shpk, ka selinë e saj pranë zyrave të Bashkisë Vau Dejës, Rruga Qafa e Gurit, Vau Dejës.

Kreu II

Kapitali i shoqërisë.

Neni 5

Vlera dhe pagesa e kapitalit të paguar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind)lekë. Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si vijon:

Lloji i kontributit është në para ne vlerën 100(njëqind)lekë, 1 kuote, që përbën 100 % vlerën e kapitalit themeltar të shoqërisë, që i përket Bashkisë Vau Dejës.

Kreu III

Administratori i shoqërisë

Neni 6

Emërimi dhe kohëzgjatja e Administratorit.

Asambledhja e përgjithshme zgjedh një ose më shume persona fizike si administrator të shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare (pesë), në pajtim me parashikimet e Ligjit nr 9901 datë 14.04.2008 , i

ndryshuar. Emërtimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë më shumice të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratori i parë i shoqërisë për një periudhë 5 vjecare do të jetë Z. Sabah Ymeraj.

Kreu IV

Dispozitat përfundimtare

Neni 7

Marredheniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Kodit të Punës si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Ortaku i shoqërisë nuk kufizohet në rritjen e kapitalit të Shoqërisë. Mosmarreveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private, midis ortakëve, punonjësve dhe personave të tretë, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, mbetet në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë percaktuar dhe iniciale të emërimit tregtar. Modalitetet për ndryshimin dhe kompetencat e administratorit, kompetencat dhe marrja e vendimeve të Asamblese së Përgjithshme, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar, etj, do të rregullohen nga Statuti i Shoqërisë dhe Ligji 9901 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar si dhe Ligi 9723, datë 03.05.2007 "Për QKB", i ndryshuar.

Ky akt themelimi është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

Vau Dejës me datë ____ . ____ .2022

THEMELUES